



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 16.02.2022

Fjala e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi në konferencën e organizuar nga KRIIK me temë “Shoqëria civile dhe politike; për një dialog dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse – nevoja për një reformë të plotë zgjedhore; financimi i politikës”.

Të nderuar pjesmarrës,

Iniciativat e grupeve të ndryshme të interesit për të shtyrë e nxitur kryesisht faktorin politik për një reformë të re dhe të plotë zgjedhore, i kanë vlerat e tyre në çdo kohë. Dhe me këtë rast ato duhet të përshëndeten e duhet t’ju jepet jehonë nga kushdo tjetër i interesuar për zgjedhjet si një proces ligjor dhe politik, si dhe për qeverisjen e vendit në përgjithësi.

KRIIK vazhdon të demonstrojë vullnet, energji për të kontribuar në këtë drejtim. Ndaj, është e natyrshme që ti përcjellim falenderimet dhe vlerësimet pozitive kësaj organizate për qëndrueshmëri dhe vazhdimsi në sjelljen në vemendje, veçanërisht të faktorit politik, të nevojës për një reformë të thellë dhe të gjithanëshme zgjedhore. Është pozitive që KRIIK nuk është e vetme në këtë angazhim. Ka disa organizata të shoqërisë civile të cilat realisht janë të përfshira në këtë proces nxitës.

Besoj se të gjithë në këtu e dimë që sikurse çdo reformë ligjore dhe më shumë akoma ajo zgjedhore janë në radhë të parë procese politike. Si të tilla, ato nuk mundet të injorojnë interesat e tilla të aktorëve kryesor politik, sikurse janë partitë.

Ndaj, sikurse mundet të merret me mend është e vështirë që nga procese të tilla reformuese, shoqëria civile, apo edhe grupe të tjera interesi të marrin rezultatin më të mirë të dëshiruar.

Por, ngelet gjithmonë me rëndësi ajo që, aspekte të cilat lidhen direkt me respektimin e standarteve më të mira ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme të gjejnë trajtesën e merituar në kuadër të një reforme zgjedhore.

KQZ i bashkohet interesit të shoqërisë civile për ta shtyrë përpara procesin e reformës zgjedhore dhe për të patur në fund të saj një produkt që më sëpari konsideron dhe merr parasysh interesat e votuesve, interesat e shoqërisë në tërësi.

E vlerësojmë të dobishme për të gjithë të interesuarit në këtë reformë të re të pritshme, përfshi këtu edhe për partitë politike, kontributin e KQZ me eksperiencën e saj. Ka jo pak aspekte të procesit zgjedhor, të cilat në vlerësimin tonë meritojnë të adresohen në kuadër të kësaj reforme.

Ne si institucion nuk kemi, nuk mundet të kemi dhe nuk do të preferonin të kishim një opinion



tonin institucional mbi sistemin zgjedhor, i cili do t'i përshtatet më mirë karakteristikave politike, ekonomike, kulturore, historike, etj të shoqërisë sonë.

Por ne si institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në vend, çmujmë se është me interes për të gjithë faktorët, që të kemi zë në këtë reformë për shumicën e aspekteve administrative, teknike dhe organizative të procesit zgjedhor, të cilat reforma e re pritet t'i konsiderojë, apo më mirë të themi rikonsiderojë.

Përbrëja, organizimi dhe funksionimi i komisionve të niveleve të dyta dhe të treta, apo në tërësi administrimi i procesit zgjedhor në nivel lokal, votimi nga jashtë, procedurat e ankimimeve, regjistrimi i subjekteve zgjedhore, fushata elektorale, pasqyrimi fushatës në media dhe monitorimi i saj, procedurat e nxjerrjes së rezultatit, vëzhgimi i zgjedhjeve, denoncimet, sjellja e administratës publike dhe përdorimi i aseteve publike gjatë periudhës zgjedhore, si dhe patjetër financimi i fushatave, apo dhe i partive politike në tërësi, janë disa nga çështjet që ne si institucion mendojmë se duhet të jenë në listën e atyre që duhet të trajtohen në kuadër të reformës së re zgjedhore.

Mendoj se është koha për të ndryshuar rrënjësisht disa aspekte të përgatitjes dhe administrimit të procesit zgjedhor, kryesisht ato teknike.

Nga njëra anë mendoj se, partitë politike do të duhet të kenë akoma edhe për pak kohë, disa të drejta dhe përgjegjësi në procesin e përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve, por nga ana tjetër duhet që persona teknik, jo të propozuar nga zyrat e partive të jenë ata që kanë më shumë përgjegjësi në administrimin dhe menaxhimin e aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor. Do të ishte ideale që partitë të mos përfshiheshin fare në përgatitjen, administrimin dhe menaxhimin teknik të zgjedhjeve, por duhet të jemi realist që sot kjo nuk është mundur. Mungesa e theksuar e besimit të ndërsjelltë të palëve politike në vend, nuk le vend për një model të tillë. Të paktën për momentin. Por ka formula të tjera të tilla që, nga njëra anë sigurojnë besimin e palëve në procesin përgatitor dhe administrues të zgjedhjeve, e nga ana tjetër garantojnë zhvillimin e këtyre procesve në mënyrë profesionale dhe jashtë ndikimit të partive politike.

Duke ngelur sot vetëm tek një nga çështjet e sipërcituara, sikurse është ajo e financimit të partive politike në tërësi dhe të fushatave zgjedhore në veçanti, që në krye të herës dua të them që të paktën në aspektin normues, sot Kodi Zgjedhor ka rregulla të cilat synojnë të rrisin transparencën dhe ti bëjnë partitë politike më llogaridhënëse për paratë që ato marrin dhe shpenzojnë për aktivitetin e tyre politik në tërësi dhe fushatat zgjedhore në veçanti.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2020 kanë synuar pikërisht këtë qëllim.

Por megjithatë, unë mendoj se ne jemi akoma shumë larg standardit të vendeve të demokracive



perëndimore, modelet e të cilave ne synojmë t'ju ngjajmë.

Ndaj, mendoj se reforma e re e pritshme zgjedhore duhet të adresojë disa nga aspektet e financimit të fushatave të partive politike dhe të subjekteve të tjera zgjedhore.

Kështu duket se ka nevojë për rregulla më të qarta mbi regjistrimin, deklarimin dhe publikimin e fondeve jopublike që përfitojnë subjektet zgjedhore. Ky opinion është kështu edhe për shpenzimet elektorale.

Ne mendojmë se ka nevojë gjithashtu për të qartësuar procedurat e përzgjedhjes së audituesve të fondeve të përfituara nga partitë dhe/ose kandidatët për fushatë zgjedhore.

Kështu ne çmojmë se duhet të ndryshojë koha, apo momenti kur këta auditues përzgjidhen për të kryer detyrën e ngakuar nga ligji.

Do të ishte mirë që audituesit të ishin të gatshëm për të filluar procesin e auditimit ditën tjetër pas ditës së votimit, ose të paktën përzgjedhja e tyre të bëhej menjëherë pas ditës së votimit. Nuk e di përse aktualisht Kodi Zgjedhor ka përcaktuar si kohë të përzgjedhjes së tyre, “jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve”.

Ndryshimet e reja të mundëshme të Kodit Zgjedhor në lidhje me këtë pikë do të duhet të përcaktojnë qartë edhe protokollin e punës së audituesve.

Nga ana tjetër mendoj se ka nevojë për të përcaktuar edhe disa garanci për ata auditues që angazhohen në auditimin e fondeve të partive, apo të kandidatëve. Ne nuk mundet të mos konsiderojmë realitetin politik dhe social ku këta auditues do të duhet të bëjnë punën e tyre.

Konsideratat e mësipërme për audituesit vlejné edhe për monitoruesit e fushatës.

Ka nevojë për një përshkrim më të mirë të përgjegjësive të monitoruesve të fushatës zgjedhore. Duhet të jetë e qartë fusha e veprimit të tyre dhe kompetencat. Eksperienca e shkuar ka treguar se kjo përgjegjësi shpesh është ushtruar në mënyrë formale, pa përmbajtje. Ndoshta duhet të gjejmë një formulë tjetër të monitorimit të fushatës.

Neni 92/4 i Kodit Zgjedhor, në vlerësimin tim është shumë i përgjithshëm në kuptim të “monitorimit të fushatës”.

Nuk është e qartë kush bën, çfarë, ku dhe si.

Nga ana tjetër nuk duket se Kodi Zgjedhor parashikon të drejtën apo përgjegjësinë e KQZ-së për të zhvilluar këtë aspekt rregullues nëpërmjet akteve nënligjore që ka kompetencë të miratojë.

Gjithashtu mendoj se, si audituesit, po ashtu edhe monitoruesit, jo vetëm që duhet të jenë përzgjedhur nga KQZ kohë përpara momentit kur ata duhet të ushtrojnë detyrën përkatëse, por do të ishte mirë që personat e tillë të përzgjedhur një herë, ata të kishin një vazhdimësi në këtë



angazhim të tyre.

Kjo do t'i jepte mundësi KQZ-së të trajnonte këtë kategori më mirë dhe në mënyrë të vazhdueshme. Kjo njëra anë. Ana tjetër është ajo që eksperiencia e tyre në monitorim apo në auditim rrit efikasitetin e procesit që ata kryejnë.

Një aspekt tjetër i lidhur me transparencën e financimit të partive politike, apo edhe subjekteve të tjera është rritja e kapaciteteve institucionale të KQZ.

Nëse kërkohet të hetohet dhe të verifikohet më thellë dhe më konkretisht në lidhje me, sa para marrin partitë, nga i marrin ato, si i shpenzojnë ato, atëherë do të duhet jo vetëm ti përcaktojmë më qartë dhe në mënyrë më të plotë këto kompetenca në ligjin zgjedhor, por çfarë është më e rëndësishme, KQZ duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe ato financiare, për ta ushtruar si duhet këtë përgjegjësi.

Është bërë tashmë rutinë, dhe kjo jo vetëm për ligjin zgjedhor, por për legjislacionin në tërësi, që ne nuk llogarisim mirë kostot që angazhojnë përgjegjësi të caktuara që ju mveshim institucioneve të ndryshme. Ndaj, dua të sjell në vëmendje të të gjithë aktorëve, por vecanërisht të Kuvendit dhe qeverisë që ka nevojë për mbështetje të KQZ në rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të këtij institucioni në kuadër të transparencës në financimin e fushatave zgjedhore.

Përsa i përket KQZ-së dhe asaj çfarë ky institucion është duke bërë në këtë moment, do të bëja prezent angazhimin tonë për të përmirësuar teknikisht procesin e raportimit dhe të administrimit mbi financimin e partive dhe fushatave elektorale.

Me partnerët tanë ndërkombëtarë po punojmë për të ndërtuar një platformë më mirë të aksesueshme dhe informuese për të tretët mbi raportet e auditit. Ky projekt përfshin edhe përmirësimin e portalit të raportimeve dhe denoncimeve që vijnë edhe nga qytetarët.

Fokus kemi edhe programet e trajnimit të stafit të KQZ, por edhe të atyre që me kohë të pjesshme angazhohen në proceset e raportimeve, auditimeve dhe monitorimeve të fushatave dhe financimit të tyre.

Gjithë qëllimi është që, duke përmbushur kështu edhe rekomandimet e OSBE/ODIHR, për zgjedhjet e ardhshme, ne të bëjmë një progres domethënës në standardin e zgjedhjeve të ardhshme vendore të 2023.

Faleminderit!

